

Titulli i lëndës: HISTORIA E ARTIT

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës
Titulli i lëndës:	Historia e Artit
Niveli:	BscA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	3
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc.Dr. Florina Jerliu
Të dhënat kontaktuese:	Florina.jerliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Historia e Artit shtjellon krijimtarinë artistike dhe kontekstuale prej parahistorisë deri në kohët bashkëkohore, të shfaqur nëpërmjet dëshmimeve materiale në formë të objekteve dhe imazheve të krijuara nga dora e mjeshtrit, artistit apo arkitektit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me elementet dhe parimet themelore të artit, si dhe veprat më përfaqësuese të artit botëror figurativ dhe aplikativ, në kronologjinë dhe kontekstin e tyre historik, gjeografik dhe artistik; njohja dhe të kuptuarit e periudhës artistike, kategorive artistike dhe veçantive të tyre (arkitekturë, skulpturë, pikturë, fotografi, arti performativ, etj.), drejtimit, stilit dhe mjeshtrit, artistit apo arkitektit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none">– interpretojë periudhat artistike në kronologji historike– identifikojë karakteristikat themelore artistike të periudhave historike– analizojë dhe interpretojë veprat e rëndësishme artistike dhe kontekstin e tyre (sipas periudhave stilistike, vendit, drejttimeve, tipeve, strukturës, materialit dhe teknikës së aplikuar)– Aplikojë njohuritë e fituara në kualifikimin e veprave të artit në hulumtimin akademik
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Njohja e historisë së artit, përkatësisht, kontekstit historik dhe artistik të veprave kulminante të civilizimit njerëzor përbën referencën themelore të njohurive gjithëpërfshirëse të botës artistike dhe njëherit hapin e parë dhe të nevojshëm në procesin e formësimit akademik të studentëve të arkitekturës.
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)	
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave interaktive, diskutimeve, prezantimeve të punës së studentëve

Metodat e vlerësimit:	<i>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%. Vijueshmëria dhe angazhimi 10% Vlerësimi nga testet 45% ose provimi final 90%</i>	
Literatura primare:	Jerliu, F. (2023). Histori e Artit, UP, Prishtinë Stokstad, M, Cothren, M. W. (2011) Art History - Volume One. Fourth Edition, Pearson Education, Inc., New Jersey Stokstad, M, Cothren, M. W. (2011) Art History - Volume Two. Fourth Edition, Pearson Education, Inc., New Jersey Ching, F.D.K. et.al. (2017) A Global History of Architecture, Wiley, New Jersey	
Literatura shtesë:	David Hopkins (2000). After Modern Art. 1945-2000. Oxford University Press Nigel Spivey (2005). How Art Made the World. A Journey to the Origins of Human Creativity, Basic Books, USA E.H.Gombrich (1995).The Story of Art. Phaidon Press, USA James Elkin, Ed. (2007). Is Art History Global, Routledge, NY	
Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjëratisë	Ushtrimet
Java 1:	Hyrje në lëndë	n/a
Java 2:	Arti Parahistorik; Arti i Lindjes së Afërt të Lashtë	
Java 3:	Arti i Egjiptit; Arti i Egjeut	
Java 4:	Arti klasik grek dhe romak	
Java 5:	Arti i Hershëm hebraik dhe i krishterë; Arti bizantin; Arti islamik	
Java 6:	Arti mesjetar në Evropë: Mesjeta e hershme, Romanika, Gotika	
Java 7:	Vlerësimi intermediar	
Java 8:	Renesanca Italiane dhe Renesanca Veriore	
Java 9:	Baroku dhe Klasicizmi	
Java 10:	Neoklasicizmi dhe Romantizmi	
Java 11:	Avangarda	
Java 12:	Arti Modern	
Java 13:	Arti Postmoden & Gobalizmi	
Java 14:	Arti aziatik, Arti indigjen amerikan, Arti afrikan	
Java 15:	Vlerësimi përfundimtar	

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ligjëratat janë obligative; ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë; inkurajohet dhe vlerësohet bashkëbisedimi dhe interaksioni gjatë analizës; folësi dëgjohet nga të gjithë; inkurajohet shfrytëzimi i teknologjisë së mençur për diskutime dhe prezantime të tipit “fun facts”, ndërsa nuk lejohen përdorimi i tyre për aktivitete tjera si kontrollimi i e-mailit personal apo rrjeteve sociale.

Shënim | Nëse vlerësimi i studentit në vijueshmëri dhe angazhim aktiv në klasë është nën 50% të kuotës vlerësuese, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t’i nënshtrohet provimit final.